

LUCIA NADIN

**FRANÇESKANËT VENECIANË
NË SHQIPËRINË E SHEKULLIT XVII**

Janë në proces transkribimi e botimi tri tekste të etërve françeskanë venecianë që patën vepruar në Shqipëri në dhjetëvjeçarët e parë mbas themelimit të misionit të mbështetur nga Kongregacioni i Propaganda Fide-s në Romë. Janë vepra të Fratit Angelo da Bergamo (1634-1640), fra Cherubino Camus di Valle Bona (1634-1648), fra Leone da Cittadella (Padova: 1646-1655 afërsisht).

Të ruajtura në Arkivin françeskan të Venedikut, në Marghera, tekstet u sollën në selinë provinciale së cilës i përkisnin në përmbyllje të përvojës misionare të këtyre të fundit, si akte kujtese për t'u ruajtur e transmetuar edhe përmes ndonjë botimi të mundshëm.¹

Bëhet fjalë në pikëpamje strukture formale për materiale të ndryshme nga ato që dërgoheshin në Romë në formë relacionesh dokumentare të jetës misionare në Shqipëri e që redaktoheshin nga Prefekti apo Zëvendës-prefekti në detyrë, materiale këto që qenë njohur në kohën e tyre e qenë studiuar në arkivin e Vatikanit duke u transkribuar pjesërisht.

Në brendinë e tyre ato mund të ofrojnë episode tashmë të përshkuara në relacione të dërguara në Romë: le të vlejë si shembull për të gjitha kronika, aq e trishtuar dhe aq e njohur nga të gjithë, e martirizimit të pësuar prej misionarëve

¹ Arkivi historik i Provincës Veneciane (më tej ASPV), Fondi S.Michele, tre missione (Albania, America, Costantinopoli, Terra Santa ecc.), fashikulli Albania:

1) ANGELO DA BERGAMO, *Breve relatione di tutto quello che dal anno 1634 insino al presente 1640 è occorso nella Missione Apostolica di Albania luogo sogetto [sic] al barbaro dominio del gran Turco, et a Padri Reformati di S. Francesco di essa. Composto dal Padre frat'Angelo da Bergamo della Riforma di Roma, Missionario Apostolico di essa, nella quale sommariamente si contiene la qualità delli Paesi, delle genti, e loro costumi, et la gran conversione di quelli popoli illustrati nella S. fede e religione cristiana.*

2) CHERUBINO CAMUS (CAMUSO/ CANUSO) da Praso in Valle di Bono (Trento), *Breve relatione d'alcune cose notabili ocorse nella Missione.*

3) LEONE DA CITTADELLA (Padova), *Successi di alcuni nostri frati Minori Riformati Missionarij d'Albania, et altri fatti adherenti nelli travagli dell'Albania.*

Mbetet mjaft e dëmtuar gjendja e dorëshkrimit të Fra Cherubinos, për të cilin paraqet urgjencë dhe domosdoshmëri një ndërhyrje restauruese.

italianë në fund të viteve '40, me nguljet e tmerrshme në hu të Giacomo da Sarnano-s dhe Ferdinando da Abissola-s.

Shkrimet e tre françeskanëve venecianë, dhe pse në titull ruajnë diciturën “relacion”, që përdorej për të përshkruar çka ndodhte në mision, ishin nisur të ishin shkrime pothuaj private, raporte të përvojave personale, autobiografi të vogla; duhet të kishin një dobi a njëfarë qëllimi të caktuar. Edhe në një vështrim të tillë, duhet të analizohen duke pasur parasysh që publiku italian të cilit i drejtoheshin nënkupton dhe jospecialistë të sektorit, të painformuar me situatën në Shqipëri.

Të tri tekstet janë të një niveli të çmuar dokumentar për historinë socio-kulturore e gjuhësore të Shqipërisë. Mjafton të kujtojmë që përmbajnë mjaft fjalë në gjuhën shqipe, pjesë dialogësh në të cilët risillen shprehje bisedore në proces përdorimi (në veçanti ajo e fratit Leone), duke sjellë materiale për historinë gjuhësore të vendit.

Bëhet fjalë kryesisht për tekste të një lënde fetare, por dhe për tekste me interes ndërdisiplinor, madje dhe për tekste që duke bërë pjesë në një panoramë përvojash udhëtimi, janë të cilësueshme si vepra odeporike* në një vështrim më të gjerë.

Në një vështrim të parë ato janë shtysë për hapjen e një debati kompleks, aq më tepër nëse vihet në raport me një aktualitet që në panoramën e raporteve ndërfitare ka nxjerrë si të pavend çdo vlerësim mbi epërsinë apo inferioritetin, çdo vlerësim meritash të besimeve të ndryshme; gjithnjë nga ky këndvështrim mund të diskutohet mbi kufijtë e autoreferimit që i ka prodhuar në mënyrë të pashmangshme e që del në pah nga dialogët e shpeshtë të përfshira në tekstet në të cilat feja e krishterë e ajo myslimane vihen përballë me ngjyrimet mjaft të ndezura, me shprehje të një ashpërsie të skajshme. Për historinë specifike të Shqipërisë, ato ofrojnë një kuadër tejet heterogjen duke qenë se bëhej fjalë për besime të ndryshme në atë kohë, të formuara nga një shumicë e gjerë myslimane dhe nga pakica të krishtera, nga të krishterë të konvertuar me forcë, nga të krishterë të quajtur “skizmatikë” dhe në luftë me katolikët: një tablo e cila, *mutatis mutandis*, do të vijojë të qëndrojë si shenjë dalluese në historinë e vendit.²

Nga një tjetër këndvështrim ato mbeten dokumente mjaft interesante, p.sh., nga një pikëpamje antropologjike me analiza e përshkrime zakonesh e përdorimesh qoftë në pikëpamje private, ashtu dhe publike. Fotoografojnë struktura sociopolitike me një diversitet të thellë mes zonash të të njëjtit territor; hedhin dritë mbi gjendjen e mjeruar të arsimit në vend dhe mbi përprjekjet më të para për t'u qasur ndaj alfabetizimit, të kufizuar gjithsesi në

* Vepra përshkrimesh udhëtimi. (Shën. i red.)

² Mbetet një referencë e detyrueshme pikërisht: Roberto Morozzo Della Rocca, *Nazione e religione in Albania*, Besa, Nardò (Lecce), 2002.

sferën fetare. Orientojnë ndaj dinamikash ndërkombëtare në ndeshjen e gjatë mes Perandorisë Otomane dhe vendeve të Evropës, mbi të gjitha republikës së Venedikut. Mbeten këto dinamika që luajtën mjaft rol në jetën e misionarëve dhe motivuan martirizimin e tmerrshëm të disa prej tyre. Për vetë faktin që ofrojnë pjesëza gjuhësore të shqipes, që shfaqen në dialogët a diskutimet mes fetarëve dhe prijësve turq, ato mund të ofrojnë lëndë të pasur për studiuesit e historisë së gjuhës shqipe.³

Ato përbëjnë në tërësinë e tyre një thesar mjaft të vyer në pikëpamje të kërkimeve të ardhshme mbi historinë e Shqipërisë.

Sa për këndvështrimin e tretë që lidhet me panoramën e gjerë të shkrimeve të udhëtarëve, ato kanë një referencialitet krejt të veçantë, meqë bëhet fjalë për një tip udhëtimi krejt të përveçëm, që i mbushur me pasiguri, i bën sfidë një toke jo vetëm të huaj, por tejet armiqësore, duke kërkuar dhe shtypa projektet

³ Kohët e fundit është gjendur nga Mark Palnikaj në bibliotekën Romolo Spezioli të Feros në krahinën e Markeve një dorëshkrim i Atë Giacinto da Sospello-s, për të cilin ishte dijenia se ekzistonte, që përmban copëza relacionesh të etërve franceskanë: prefekti Cherubino, Bernardo da Verona, Antonio da Spoleto, Giacinto da Sezza; gjithë ky material që bashkuar në vitin 1652 nga Giacinto da Sospello, pikërisht, në një kronikë kronologjike të jetës së misionarëve, të paracaktuar t'u dërgohej në Romë kardinalëve të Propaganda Fide-s, gjë që nuk u realizua. Në kronikën përkatëse qenë vënë në përdorim tekstet e cituara më sipër dhe që me shumë gjasë qarkullonin mes tyre. Sa u përket relacioneve të mbërritura në Romë, në zyrat e Propaganda Fide-s, referojmë punën e çmuar të përmbledhjes e të transkribimit të kryer nga Injac Zamputi, nga e cila këshillojmë të shihet më së pakti: *Relacione e Documente për historinë e Shqipërisë (1610- 1650). Relazioni e Documenti per la storia dell'Albania (1610-1650)*, Albanisches Institut Faik Konica, St. Gallen- Pristinë, 2018, përgatitur nga Albert Ramaj. Sa i përket bibliografisë së pamatë studimore mbi misionet franceskane në Shqipëri, nga Cordignano e Valentini, nga Bartl, Jačov, Marlekaj, Pizzorusso, Moroni, Sarro, Gurga, citojmë studimet e përmbajtura në: *L'Albania nell'archivio di Propaganda Fide. Atti del convegno Internazionale, Città del Vaticano, 26-27 ottobre 2015*, a cura di Ardian Ndreca, Urbaniana University Press, 2017; gjithashtu dhe studimet e shumta në revistën "Hylli i Dritës", që mbetet domosdoshmëri referimi. Kës. edhe kolanën me studime e tekste që botohet nga françeskanët e Shkodrës, mes të cilëve, përmendim punimet e Marian Prelaj O.F.M. me titull *Shqypnija Serafike e Misjoni Shetitës i Françeskajvet neper Shqypni*.

Nuk është gjendur deri më tani përmbledhja me tekste që Camillo Libardi (për të cilin kës. *Sylva documentorum spectantium ad Missionem Pulatensem*, Albanisches Institut, 2022) pohonte të kishte hartuar dhe dërguar në Romë. Profile biografike të disa misionarëve në Shqipëri, ndër të cilët dhe Atë Cherubino, lexohen në *Leggendario francescano* të Benedetto Mazzara-s, botuar në Venedik në dy botime të viteve 1676 dhe 1689. Gjithsesi, jo përherë të dhënat që lexohen aty janë të besueshme, të paktën (siç është ndeshur) ato që lidhen me misionarët që konsiderohen në studimin tonë të pagabueshme sepse ofrohen nga vetë protagonistët.

për t'u përmbushur, dhe që mbart tensione jo fort të lehta për t'u përballuar me këdo që i bashkohet ndërmarrjes. Është një udhëtim në të cilin risku i pazakontë (dhe pse një element përherë i bashkëlidhur) zgjerohet në një horizont që e ridimensionon tërësisht njeriun, në të cilin bëhet qëllim dhe sakrifikimi i trupit, gjë kjo e pashmangshme. Turbullon e trondit këdo që lexon kronikën, sepse shtyn drejt një pyetjeje të një rëndësie të madhe: cila forcë e brendshme, çfarë kurajoje e vendosmëri idesh, çfarë plotësie e fuqie besimi mban gjallë një individ që vë në rrezik dhe jetën e vet, jo për t'u shpërguar individualisht, por në funksion të të tjerëve, për t'u bërë më tej simbol, zë i shpresës dhe i utopisë?

Në reflektim të një pyetjeje të tillë, mjaft shqetësuese në një kohë në të cilën shfaqen të rralla shtysat për të operuar në drejtim ndryshimesh të thella, duke qenë se duket se mungojnë zëdhënësit e ndryshimeve rrënjësore, rrëfimi i udhëtimeve krejt të veçanta të tre françeskanëve venecianë turbullon, shqetëson, ngjall kuriozitetin dhe shtron pyetje përtej lamijes specifike fetare në të cilën ato qenë përfshirë.

Ky është (besojmë), impakti i parë i leximit, për çdo lexues.

Nëse mandej lexuesi ka në bagazhin e vet kulturor e fetar referime konkrete ndaj rrëfimesh biblike, ndaj traditash hagjiografike, nëse njeh traditën françeskane, së cilës i përkasin protagonistët e ngjarjeve që trajtojmë, e “marrinë e shenjtë” të themeluesit, Françeskut të Assisi-t, atëherë ndeshtrashat e atij grushti njerëzish për të cilët bëme fjalë mund të ndiqen dhe në gjurmët e Palit të Tarsit, si një rrëfim epifanik i “spes contra spem” (shpresës kundër shpresës). Kur u duhet të kalojnë nga Raguza (tokë veneciane) në viset shqiptare që janë territor otoman e të gjithë i paralajmërojnë për një martirizim të sigurt, kur prej tetë vetave mbeten vetëm dy e ata të dy gjithsesi janë të vendosur të vijnë më tej, janë pikërisht arsyet e besimit të tyre në Hyjin që mbizotërojnë ndaj çdo mëdyshjeje njerëzore. E atëherë leximi bëhet burim kurioziteti, të habit dhe të rrëmben.

Do të paraqiten këtu disa copëza të relacioneve për të dokumentuar interesin që shfaqin si në pikëpamje të njohjes së shkallës së arsimimit në Shqipëri në shekullin XVII, ashtu dhe në atë të dëshmimeve në gjuhën shqipe.

Rrëfen Angelo da Bergamo që, në kushtet e situatës fort të mjeruar të popullsisë së krishterë, në mungesë të elementeve themelore të besimit fetar, spikat përvoja në Blinisht e fra Carlo dalla Mirandola-s, i cili ngriti një shkollë të frekuentuar nga rreth pesëdhjetë të rinj të krishterë, si një përvojë me miratim të plotë nga ana e vendasve, e që i shërbente një përgatitjeje ndaj njohjes së shkrimit dhe virtyteve të krishtera. Kronisti nuk specifikon, për fat të keq, cili mund të ishte programi i fra Carlo-s e me cilat mjete punonte. Supozohet që mësonte shkrim e këndim dhe njohje të katekizmit. Nga Roma mbërrinin gjëra të nevojshme për Misionin: përtej instrumenteve të vogla të ritit (fugure, Agnus Dei) sigurisht mund të hipotetizohet ndonjë tekst, p.sh.,

Doktrina e shkurtër e Bellarminos, e cila nga viti i botimit 1597 e më tej, pati një përhapje mjaft të gjerë e përbënte tekstin bazë për përkthime në gjuhë të ndryshme.

Puna me analfabetizmin ishte një nevojë urgjente e shprehur dhe nga meshtarë e ipeshkvinj të angazhuar në Shqipëri. Të kemi parasysh, p.sh., Pjetër Budin, që kishte përkthyer tekstin e Bellarminos në vitin 1618. Nga ç'shkruan fra Cherubino (për të cilin do të flasim më tej) arrijmë të marrim vesh që tekstet në përdorim ishin Rituali dhe Pasqyra e pendimit.

Në mënyrë më të detajuar pikërisht fra Cherubino rrëfen që dha fryte të mëdha një mision i drejtuar nga Atë Benedetto da Treviso e dhe nga Atë Giacinto da Sospello në viset e Pëdhanës dhe të Zoimenit, në rrëzë të maleve të Bolgarit, Mirditës, Scelli, Zela*, Kurbinit. Ishte larg rreth pesëmbëdhjetë milje nga misioni i Zadrimes dhe rreth dhjetë milje nga Lezha. Aty qe themeluar një shkollë, shkolla e Rruzares, në të cilën Atë Giacinto dha mësim përreth nëntë vjet e ku të rinjtë mësuhan në mënyrë të përsosur gramatikë dhe nocione të besimit. Shkolla më tej u shpërbë për arsye të polemikave të shumta të personave që e gjykonin të padobishme rreptësinë që ushtrohej në të, ndërkohë që gjetkë mund të bëheshe meshtar me sprova më të vogla.

“...Në këtë mision (ishte) Atë Benedetto Trivisano, mjaft i aftë në gjuhën e vendit, të cilën e kishte përvetësuar në pothuaj një vit dhe ishte mjaft i kualifikuar dhe me një natyrë që u përshtatej këtyre njerëzve e dukej kështu i zgjedhur për ta si një apostull i vërtetë i Shqipërisë; siç thuhet dhe nga Atë Bonaventura që kishte hirin të bënte për vete çdo njeri që i afrohej, kështu edhe ipeshkvinjtë, priftërinjtë, të krishterët dhe myslimanët i tërhiqte me aftësinë e tij që të bënin çfarë dëshironte, e prandaj ishte dhe themelues i pesë misioneve, dhe ishte i dashur për çudi nga të gjithë, mjaft rezultativ në çdo gjë⁴. Bashkëvëllai i tij, i sipërpërmenduri Atë Giacinto da Sospello, edhe ai ishte një klerik i aftësuar në të gjitha gjuhët, e kështu sollën mjaft fryte në këtë Mision, duke themeluar shkollën e Rruzares. Ndërsa ishte në jetë, i mbronte njëfarë zoti Mozzecat, dhe i mbante me lëmoshë të mëdha, por ky u vra e më tej patën shumë trazime prej turqve, në vecanti në viset ku kalohej për të ardhur nga Kostandinopoja, nga Elbasani, Coira (sic! = Kruja) në qytetin e Shkodrës. Atë Giacinto themeloi një shkollë prej 15-20 të rinjsh e dha mësim për gati nëntë vjet, e aty u mësuhan në mënyrë perfekte gramatikë e gjërat e fesë. Shumë prej tyre janë bërë klerikë. Të tjerë, duke parë sa pak rëndësi i jepej dijes e duke vënë re që disa prelatë lehtësisht urdhëronin të bëheshin klerikë disa të paditur, u larguan nga shkolla, duke thënë: “këta, pa ditur asgjë u bënë kaq

* Sot Bulgri e ndoshta Selita e Kthella, bajrakë të Mirditës. (Shën. i red.)

⁴ Atë Cherubini shkruan se Benedetto da Treviso kishte hartuar një “përshkrim” të Shqipërisë, me siguri ajo që më vonë u përdor nga Giacinto da Sospello në kompilimin e tij të vitit 1652.

lehtë priftërinj, po ne pse vrasim mendjen me këta fretnit? Dhe kështu më pas shkolla u zhbë, ose në fund në të shkonin krejt pak veta.

Edhe në oratorin e Troshanit u ndërmor një tentativë për të hapur një shkollë.

“Tri milje larg prej oratorit të Shën Mërisë Triumfuese të Troshanit kishte një ngulim prej 150 shtëpish të gjitha të krishtera, mjaft të populluara; në disa prej tyre kishte 30, 40 apo 50 për shtëpi e në veçanti me një numër të madh fëmijësh. Kështu iu drejtuan lutje misionarëve nga vetë popullsia që të ngrinin një hospic në atë vend për të mësuar doktrinën e krishterë, për t’u mësuar shkrim e lexim atyre që ishin më të aftë, për të predikuar e thënë meshë (.....) Mënyra e rendi do të ishin të tillë: në mëngjes vinin mjaft njerëz në meshë, dëgjohej mesha [.....], dhe çdo gjë në gjuhën amtare, në mënyrë që të kuptohej nga të gjithë. Më tej mbeteshin 50 të rinj të cilët mësuan të lexonin si dhe zakonet e të qenit të krishterë.....mësohej doktrina e krishterë dhe në pesë ose gjashtë muaj të gjithë mësuan të lexonin e të shkruanin. Më shumë se 15 veta kishin filluar të mësonin gramatikën, duke pasur disa prej tyre mjaft aftësi në këtë gjë e këta vetë më tej shkonin në shtëpitë e tyre e u mësuan etërve, nënave e të afërmve të tyre, prej ku mund të shihej dhe fryti i mirë i gjithë kësaj.

Edhe në këtë rast iniciativa dështoi në pak kohë, meqë e kundërshtonin dhe vetë polemikat me ipeshkvinj e prelatë.

Domethënë, dhe vetë françeskanët ndihmuan në procesin e alfabetizimit të vendit? Do ta quajmë të tepruar një pohim të tillë, sepse u bë fjalë për përvoja të pakëta që kishin të bënin me zona në të cilat operonin misionarët, por që gjithsesi do të duhet të shënohen e të merren në konsideratë në çdo rindërtim të natyrës gjuhësore e historike.

Nga dëshmitë mbi përpjekjet e para për të krijuar qendra të shkollimit do të kalojmë tashmë në ndonjë dokumentim të rëndësishëm mbi tekste në gjuhën shqipe.

Ndodh një prej marrjeve të shumta në pyetje të fetërve, gjatë të cilave autoritetet vendase i pyesin këta të fundit për arsyet që i kanë sjellë në Shqipëri. Mbizotëron gjithnjë dyshimi që mund të ishin bartës komplotesh politike apo marrëveshesh me shtetet evropiane. Në pyetje në këtë rast merret Atë Cherubino, i cili refuzon çdo nxitje për të hequr dorë nga besimi dhe për t’iu kushtuar një jete të rehatshme e me lehtësime.

Rispose il P. Cherubino che possedeva la lingua: “E8t8ni mose 8aste meubà Tuurc maa paara mordia” [Zot’yni mos e dhashtë me u bā Tūrk, mā pārē mordja] che vuol dir: Dio ci guardi di farci turchi, più tosto la morte. “Haà bre gidi chahuri, c88 schipetar anst per te mb8tune” [Haa bre gjidī kaurri, kŷ shqipëtar ansht për të mbyttunë]: përkthen Cherubini: Haà schifosi/ ruffiani Caori, [d.m.th. të krishterë]; un tal senza fede, questo che sà la lingua, è per essere amazzato (= deve essere ammazzato), chè questi altri facilmente si faran turchi, e in particolar quel giovine intendendo frate Evangelista. (U përgjigj

Atë Cherubino që zotëronte gjuhën: [Zot'yni mos e dhashtë me u bâ Tûrk, mâ pârë mordja] që do të thotë: Zoti na ruajtë që të bëhemi turq, më mirë vdekjen. Ah kaurë të poshtër! Një i tillë i pafe, ky që di gjuhën, është për t'u vrarë, kështu që të tjerët lehtësisht mund të bëhen myslimanë e në veçanti ai i riu (nënkupto: frati Evangjelistë).


Batutat e dialogut në këtë rast janë mjaft të rëndësishme: Atë Cherubino cilësohet <**shiptar**>, apo ai që di gjuhën: termi nuk ka konotacion etnik, por tregon vetëm atë që flet gjuhën shqipe e në fakt referimi bëhet ndaj Cherubinos, që nuk është shqiptar.

Jo rastësisht termi *shqiptar* do të gjindet i përkthyer në Fjalorin e Francesco Maria da Lecce-s në vitin 1702 me “parlatore”, pohim që përkon me interpretimin e prejardhjes semantike të termit shqiptar (të regjistruar nga G. Meyer): “Njeriu që kupton gjuhën” (ashtu siç e ka shpjeguar tashmë në librin e tij të fundit me referimet e duhura bibliografike, A. Plasari⁵).

Dëshmia e Atë Cherubinos është kështu themelore për historinë e gjuhës shqipe dhe nëse akoma do të paraqitej nevoja, ripohon rëndësinë e njohjes së këtyre shkrimeve të franceskanëve, rëndësi që kapërcen materien fetare në mënyrë që të shihet si dokumentim kulturor në kuptimin më të gjere të termit.


⁵ A. Plasari, *Arbni historik, gjeografik, kishtar dhe politik*, Tiranë, 2020.

Pasazhi shfaqet dhe në tekstin e Giacinto da Sospello-s, i cili, siç u tha dhe më parë, ka marrë mjaft faqe nga Cherubino di Val di Bono. Mbi këtë pasazh ka shkruar së fundmi dhe Bardhyl Demiraj: ““Shqiptar” në një dorëshkrim të shek. XVII” në *Shêjzat – Pleiades*, janar-qershor 2022, nr. 1-2, f. 79-93. Pasazhi shfaqet dhe në tekstin e Giacinto da Sospello-s, i cili, sic është thënë dhe më sipër, ka rimarrë mjaft faqe nga Cherubino di Val di Bono. Në lidhje me këtë ka shkruar së fundmi dhe Bardhyl Demiraj, me artikullin ““Shqiptar” në një dorëshkrim të shek. XVII” in *Shêjzat – Pleiades*, janar-qershor 2022, nr. 1-2, f. 79-93. khs. Matteo Mandalà, “Shqip, shqipëtar e shqipëni në Fjalorin e pabotuar (1702) të Francesco Maria da Lecce-s” në *Vepra themelore në Albanologji*. Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare 18-20 dhjetor 2008, Tiranë, 2009, f. 151-162, ribotuar me të njëjtin titull në Matteo Mandalà, “Shqip, shqipëtar e shqipëni në Fjalorin e pabotuar (1702) të Francesco Maria da Lecce-s” in *Arbërishtja në rrjedhë të shekujve*, Naimi - Shtëpi botuese dhe studio letrare, Tiranë, 2019, f. 203-213.



Një lloj reflektimi është më se i ligjshëm në këtë rast: si ka mundësi që pikërisht Atë Cherubino, që njihte mjaft mirë shqipen, nuk përfshin në tekst shumë shprehje në këtë gjuhë? Besojmë që kjo ka ndodhur ngaqë kujtimet e tij do t'i kushtoheshin një publiku që nuk e njihte këtë të fundit dhe kështu varianti i bisedave në gjuhën italiane mund të ishte në funksion të leximit të përmbytjes. Janë më të shumta në numër tekstet në gjuhën shqipe të Leone da Cittadella-s: kjo sepse ishte qëllim i tij të përpilonte një fjalor të mirëfilltë të gjuhës shqipe, gjurmët e të cilit nuk janë gjetur akoma deri më sot.⁶ Ja, p.sh., një pasazh që u referohet një prej marrjeve në pyetje a përballjeve mes misionarëve dhe bejlerëve të vendeve në të cilat fretnit ushtronin misionet e tyre:

⁶ Khs., *Analecta franciscana sive Chronica aliaque varia documenta ad historiam Fratrum minorum spectantia*, I, f. 352, ku thuhet: Leone duhet të ketë shkruar një dicionar në gjuhën shqipe. (Leone avrebbe scritto un *Dictionarium Epiroticum*.)



Nënvizion dhe fra Leone që ata të krishterë të paktë që kanë mbetur të tillë në Shqipërinë otomane përqeshen e tallen përditë me shprehjen alla turka “*gidi caurr* [gjidi kaurr]” që në gjuhën tonë të mirë do të thotë njeri që nuk vlen asgjë, i pafe, burrë i një të përdale. Kuptimin përkatës fra Leone e ka kërkuar në gjuhën shqipe, (ai shkruan që të njëjtën shprehje përçmuese e përdorin dervishët kundër atyre që nuk janë myslimanë), “kështu, do ta kuptojë më mirë çdo lexues i devotë që do të lexojë librin tim”. Ky nënvizim është i rëndësishëm sepse dëshmon që qëllimi i shkrimit të misionarit ishte po ai që kishte frymëzuar dhe fra Cherubion: të tre misionarët venecianë regjistronin faktet e përvojës jetësore të tyre në Shqipëri në mënyrë që dhe të shihnin dritën e shtypit, që të njiheshin nga shumë veta, të njiheshin vuajtjet e pësimet e tyre. Fra Leone fton të lexojnë pikërisht ata që nuk e njohin Shqipërinë që të dinë se ç’ndodh në atë tokë: Le të lexojnë librat në shqip që ta ndiejnë frikën prej Zotit.

Ka ndonjë shembull dhe mbi vënien në dukje të zakoneve, mënyrës së jetesës, bestytive populllore të asaj kohe.

Mbi të gjitha duhen përmendur epidemitë e furishme të murtajës që shfaqeshin në Shqipëri si në gjithë Evropën, prej të cilave nuk duhet lënë në harresë epidemia shkatërrimtare e vitit 1630. Me çfarë interpretimesh fantastike

do të duhet të përjetoreshin ngjarjet dramatike që përbënin një plagë endemike të vendit?

Fra Cherubino rrëfen mbi një periudhë të përhapjes së murtajës në Zadrimë që zgjati një verë të tërë dhe për një besim të përhapur në popull që e identifikonte këtë të fundit me një qenie të gjallë, një grua, që shkonte duke lëshuar nga gjinjtë e saj qumësht të helmuar:

Kështu erdhi murtaja në Zadrimë, sidomos në Troshan dhe fretnit qëndruan të fortë, gjithnjë duke kryer rrëfimet në Orator dhe duke mësuar njerëzit jashtë tij si të mbroheshin. Ia dolën që dhe famullitarët të qëndronin, se përndryshe do të iknin të gjithë. Kjo gjë ndihmoi jo vetëm katolikët, por dhe myslimanët e më tej dhe skizmatikët. Popullsitë e këtyre anëve nuk mendonin që murtaja ishte një sëmundje e që ngjitej nga trupat e njerëzve e që mund të ishte dënim nga Hyji, por druanin se ishte një qenie e gjallë, si një grua që ecte përgjatë vendit me sisë të mëdha, që ecte duke shtrydhur qumështin e duke ngjitur të keqen, prej ku ndodhnin shumë marrëzira, vrisnin qen dhe i varnin nëpër pemë në mënyrë që të ndalohej murtaja. Të tjerët qëllonin me armë natën për ta vrrarë, të tjerë vrisnin mace të zeza e mbanin eshtrat e tyre mbi vete, të tjerë mbanin me vete helm duke menduar që do t'i mbronte; mjaft myslimanë e të krishterë thoshin se e kishin parë gjatë natës e që e kishin dëgjuar të kërcënonte njerëzit; fretnit i sqaruan dhe u hoqën nga koka këto gënjeshtër dhe i nxisnin të rrëfeshin e të merrnin kungimin, prej ku dhe u zotuan të bënë festën e Kryggës Shenjte në shtator e atë ditë të ngrinin një kryq në oratorin e Troshanit me të gjitha elementet e Pasionës duke i mbajtur në procesion, dhe atë ditë qenë çliruar plotësisht nga kjo murtajë”.

Ky qe një terren plot me bestytini në të cilin misionarët u desh të ndërhyjnë shumë, në mënyrë që ta çlironin prej tyre.⁷ Në këto tekste të misionarëve në Shqipëri, pothuaj gjithmonë të ngarkuara me tensione për lexuesin që është i përfshirë në ngjarje me arratisje e persekutime, nuk mungojnë pjesë rrëfimesh që të sjellin në mendje tregimet më të spikatura të antologjisë Fioretti të Shën Françeskut e të vetë narrativës françeskanë. Ja një i tillë, i rrëfyer nga Fra Cherubino, që të kujton episodin me Shën Françeskun dhe zogjtë, cicërima e të cilëve ndërpritej kur shenjt i predikonte.

Një ditë fretnit predikonin përballë Bunës, në Shkodër në një kishë të Shën Bakut, pranë abacisë së mrekullueshme të Shën Sergjit. Pranë kishës ishte një

⁷ Mbi valët e shpeshta të etheve malarike dhe murtajën në veçanti në Shqipëri, vërej Pëllumb Xhufi, *Et pestilentia venit*, in Bardhyl Demiraj ed., *Sprache und kultur der Albaner*. Akten der 5.Deutsch-albanischen kulturwissenschaftlichen Tagung 5-8 juni 2014, Bucimas bei Pogradec, Albanische Forschungen 37. Harrassowitz Verlag, Wiesbaden 2015, f. 101-119. Interpretimet në viset shqiptare mbi murtajën që ngjitej nga një qenie femërore lidhen me një repertor besimesh popullore që jetoj për shekuj me radhë, por që më tej u zhduk falë njohurive të mëvona shkencore.

lagunë plot me bretkosa që bënin shumë zhurmë e që nuk lejonin të dëgjohej asgjë. Misionari pati thënë: këtu nuk është e volitshme të predikosh, sepse nuk do të merrej vesh asgjë. Në të vërtetë, kuakjet nuk linin asnjë mundësi për komunikim, zëri i fratit humbiste në gjithë atë zhurmë. Filloi mesha dhe erdhi momenti i predikimit; misionari e filloi gjithsesi dhe *ja ku heshtën ato bretkosa e mbasi mbaroi predku, rifilluan sërish. I gjithë populli asistoi i mahnitur, e më tej iu falënderua pa fund Zotit*. Nuk mungojnë përshkrimet e ndonjë feste të jashtëzakonshme dhe spektakolare. Është sërish fra Cherubino që rrëfen:

Viti 1643: u mbajt një festë e madhe në një mal shumë të lartë në Mirditë, në një kishë që kohë më parë kishte qenë një abaci e madhe në fazë rrënimi; ngrihet aty një treg shumë i madh në qershor për festën e Shën Gjonit, në të cilën rendnin të vinin “...nga Zadrimea, nga Lezha, nga Kurbin, nga Kthella, nga Selita, nga Bulgari, nga Fani i madh dhe Fani i vogël, nga Luria, nga Çidhna, nga Dibra e poshtme dhe nga vise të tjera; për tri ditë ndërpritën gjakmarrjet, çdonjëra popullsi vjen e armatosur me armë të moçme shumë të bukura; me trofetë e mëdha të turqve, me flamuj të ngritur që u ishin marrë turqve në plaçkitjet e shumta që bëjnë shpesh, e më tej vijnë dhe gratë e tyre të veshura më së miri me petka që u kanë marrë turqve në plaçkitje e kështu mbledhet një ushtri e madhe e e fortë që të fut frikën, sepse gratë e tyre përbejnë një ushtri të mahnitshme meqë janë të zonjat e mjaft të afta në përdorimin e shpatës, madje edhe të arkibugjrit, mendo mandej çfarë mund të jenë burrat. Aty gjindet koka e Shën Aleksandrit roman*.

Në klimën shumëngjyrëshe të festës së Shën Gjonit në Mirditë, me paradën e një ushtrie burrash me armë të moçme e me trofe të turqve të mundur, spikat imazhi i grave me veshje të çmuara, edhe ato trofe betejash e përleshjesh, gra fort të zonjat në përdorimin e shpatës e të armëve të zjarrit. Një copë jete nga Mirdita, përmes së cilës nënvizohet, me habi, dhe bukuria dhe forca luftarake e grave.

Nuk mungojnë dëshmitë mbi kujtimin e vazhdueshëm dhe të pashlyer të Gjergj Kastriotit: fra Leone rrëfen ndeshtrashat e pafund të ipeshkvit të Durrësit, Skurës, që kur duhet të lëvizte, do të duhej përherë të ishte i shoqëruar nga 40 apo 60 trima (sipas lejes së marrë nga Stambolli), për t’u mbrojtur nga sulmet e vazhdueshme me armë prej turqve të shumtë. Fama e shoqëruesve të tij të armatosur, të pakët, por shumë të fortë, u përhap kudo duke u kthyer pothuaj në një legjendë, duke e bërë këtë të fundit një tjetër Kastriot.

* Në këtë pasazh bëhet fjalë për Abacinë e Shën Llezhdrit (Aleksandrit) në Malin Orosh të Mirditës, seli peshkopale e Peshkopatës së Arbrit dhe një nga qendrat kishtarë më të rëndësishme të trojeve shqiptare në shekujt XII-XIII. Shën Aleksandri Roman për të cilin flitet këtu është Aleksandri i Driziparës, martir në Drizipara të Trakisë, rreth vitit 300. (Shën. i red.)

“Vetëm duke dëgjuar zërin e tij, trembeshin, kaq ishte i frikshëm për Turqinë, Krujën, Tirranën (sic), Canovian dhe Albanopolin, el Bassanin (sic), Shkodrën, dhe gjithë myslimanët e zonës thoshin atë që dihej për Kastriotin, që sulltani vonoi tre vjet të besonte që kishte vdekur. Kështu, ka pasur dhe të tjerë që kanë vonuar dy vjet që të besonin se kishte vdekur, duke menduar se po tallej që të tërhiqte latinët për të zotëruar vendin, e prandaj thoshin që nuk kishte vdekur, se po të kishin besuar një gjë të tillë, do të kishin vrapuar përnjëherësh për të plaçkitur banesën e tij, por duke dyshuar për vërtetësinë e kësaj, nuk bënë gjë, duke ditur që po të ishte gjallë, do të ishte hakmarrë, e prandaj ishte thirrur një tjetër Kastriot për nga trimëria, që e druanin barbarët, të cilët shumë herë ishin mundur e mposhtur nga ata pak njerëz të tij”...

Këto tri tekste të françeskanëve venecianë përbëjnë dhe burime të dhënash arkeologjike meqë shpesh evidentojnë hollësi mbi praninë e objekteve të kultit që qenë rrënuar, ose të mbijetuar me rrënoja në shekullin XVII, si p.sh., kur tregohet që në Shkodër, pranë portës së kështjellës, banesa private ku thirret një misionar për të shëruar një të sëmurë, dikur kishte qenë Manastiri i etërve domenikanë, prej të cilit kanë mbetur akoma shenja. Ose kur tregohet që për një takim mes Pashait të Shkodrës dhe misionarëve që zgjedhur një vend larg Shkodrës, rreth katër a pesë milje, ku në një kohë të largët kish qenë kisha e mrekullueshme e Shën Sergjit. Në këtë rast, mbiemri “e mrekullueshme”(Fra Cherubino e përdor më se një herë) jep idenë e strukturave të shkëlqyeshme të abacisë së moçme benediktine, një kompleks i një madhështie të rrallë për nga dimensionet dhe veprat e artit.

Ose kur flitet për abacinë e dikurshme të Shën Aleksandrit:

“..Aty gjindet koka e Shën Aleksandrit të lidhur për besimin në Jezu Krishtin nga një i dërguar i perandorit, jeta e të cilit është shkruar nga Surio me një rrëfim fort të bukur. Ai që vlarë në Drisipari në Daki apo Panoni. I që prerë koka dhe që sjellë këtu e më tej, pas një rishfaqjeje për mrekulli i që ndërtuar një kishë shumë e madhe me një abaci mjaft të pasur, po nga tirania e turqve dhe mungesa e klerikëve që shkatërruar çdo gjë, pati mbetur vetëm koka e këtij shenjtori në një kuti argjendi me zbukurime në gurë të çmuar. Në këtë kishë kishte mjaft argjenderi, relike, paisje të çmuara, kelshejte me vlerë të madhe, por që me kohën ishin dëmtuar.

Ose për kishën e shën Gjergjit:

Një ditë, duke shkruar përtej tokave të Mirditës arritën në Lurie dhe Çidhnë, ku ka popullsi shumë më të buta e të dhimbsura, të cilat

dëshmonin një dëshirë shumë të madhe që të kishin fretnit mes tyre. Herë të tjera kishte qenë dhe Atë Salvator d'Offida e i kishte mësuar aq mirë saqë të gjithë kishin mësuar në gjuhën e vet lutjet dhe elementet e besimit tonë të shenjtë sa mahnitej kush i dëgjonte. Në një fshat ishin bërë të gjithë myslimanë disa ditë më parë dhe kishin ardhur rreth tridhjetë hoxhallarë, që ta kthenin një kishë të Shën Gjergjit në xhami.

Kësisoj tekstet e franceskanëve përbëjnë, e ripohojmë, dhe një burim të dhënash arkeologjike, meqë shpesh ofrojnë hollësi mbi praninë e objekteve të kultit që ishin rrënuar ose që paraqiteshin akoma të mbijetuara në shekullin XVII. Gjithsesi, ato u transmetojnë lexuesve një trishtim të parrëfyeshëm mbi një trashëgimi artistike të Shqipërisë mesjetare, plotësisht të humbur.

Pohojmë që tekstet e marra në shqyrtim sjellin në disa raste episode, përshkrime, të dhëna dokumentare të njohura prej studiuesve të fushës sepse përmbahen e gjinden në relacionet e shumta të ruajtura në arkivin e Propaganda Fide-s. Gjithsesi ato kanë një vlerë të shtuar sepse përbëjnë rrëfime kompakte, të paracaktuara për lexime të vyera, të këndshme gjithashtu, edhe pse përmbajtja shfaq shpesh nuanca dramaticiteti. Lexuesit i ndodh të lexojë histori jete, por dhe ndodhi që pasojnë njëra-tjetrën në të cilat falë dinamikave komplekse të teksteve narrative, edhe përfshihet duke pritur, emocionuar, duke shpresuar. Gjindemi përherë në një kuadër shkrimesh me një interes ndërdisiplinor, që ofrojnë këndvështrime të shumta leximi. Urojmë që botimi i ardhshëm i plotë i tri teksteve franceskane të mund të ofrojë mundësinë e rikthimit ndaj burimeve mbi këtë temë, duke rivlerësuar kontributet e çmuara të dhëna tashmë prej studiuesve shqiptarë, për t'u pasuruar dhe me ndihmesat e reja e më të fundit kërkimore.

Përktheu: **Evalda Paci**

SUMMARY

VENETIAN FRANCISCANS IN 17th CENTURY ALBANIA

Presented here are three texts by Franciscan missionaries from Veneto who worked in Albania in the 17th century, recently recovered in the Archives of the Franciscan Province of Venice: works by friars Angelo da Bergamo, Cherubino da Valle di Bono (Trento) and Leone da Cittadella (Padua). Only the first one was partially known, the other two are completely unpublished: all three are in the final stages of transcription and publication. They have very different characteristics from the reports that the Prefects of the Missions sent

to the offices of Propaganda Fide in Rome, in that they were conceived as small "autobiographies" with which to make known their life experience and the situation of the country where the brothers were sent to work. From this point of view, they have many vivid narrative implications.

The recovered texts are precious documents for the history of Albanian society at the time: first of all from an anthropological perspective, with descriptions of customs, habits, and the health situation (frequent waves of malaria and plague); from this point of view, they complement the documentation of the official reports to Rome, already known. Compared to these, however, they have an added and even more precious value, in that they contribute to the reconstruction of the linguistic history of the country. They contain Albanian language passages (numerous are those in the text by Leone da Cittadella), because they contain excerpts of interviews and interrogations that took place between the friars and the local authorities; therefore, expressions in the Albanian language also appear. The most important among them is the example of the term *shipetar*, which appears a few decades earlier (1639) than the year known so far (1702).

Their importance therefore goes far beyond the limited interest in religious matters; in the future, it is believed, they could be the subject of interdisciplinary study.